

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektësh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Asistent ne Shitje - Qendra COIN

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Asistenti ne Shitje realizon te gjitha funksionet e shitjes se produkteve te qendres "COIN" sipas departamentit te percaktuar

❖ DETYRAT KRYESORE

- Të ndihmojë në realizimin e synimit të caktuar për shitjet nga kompania;
- Të ndihmojë në përmirësimin e treguesve tregtarë të departamentit, përmes shërbimit cilësor ndaj klientit;
- Të kryejë me korrektësi të gjitha veprimet financiare, në lidhje me shitjet;
- Të ndihmojë klientët në përzgjedhjen e produkteve, duke u treguar i gatshëm për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të tyre.
- Mirëmban dyqanin dhe zonën e magazinimit, si dhe sistemon në vendet e duhura, artikujt e lëna në dhomat e provës;
- Mundëson paraqitjen e artikujve në sektorët përkatës, palosjen dhe vendosjen e tyre në vendin e caktuar;
- Aktivizon dhe ç'aktivizon sensorët e veshjeve në magazinë dhe në dyqan, sipas udhëzimeve profesionale;
- Mban në ruajtje artikujt e përzgjedhura nga klienti, në përputhje me procedurën e përcaktuar;
- Kujdeset për vendosjen e çmimeve në zonat e promocioneve, në vendosjen e mallrave sipas qëllimit të caktuar komercial dhe kontribuon për përmbushjen me sukses të qëllimit të eventeve promocionale të kompanisë;
- Merr pjesë aktive në procesin e inventarit të realizuar periodikisht në përputhje me nevojat e kompanisë;
- Raporton tek niveli menaxherial, për artikujt që kërkohen nga klientët, por që ende nuk janë të gatshëm për shitje;
- Merr pjesë në programe trainimi, si dhe workshop-e të ndryshme, të organizuara për rritjen e kapaciteteve profesionale për fushën në ndjekje.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Të ketë përfunduar shkolle te mesme

Gjuhe te huaja: Anglisht, Italisht

Njohuri kompjuterike: Paketa Microsoft Office

Eksperienca e kerkuar: 3 vite eksperience ne fushën e shërbimit tregtar.



Te gjithë te interesuarit, janë te lutur te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te telefonojne ne numrin e cel: **0697012345**

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 30 Nentor 2022, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrotjtjen e të dhënave personale”.